V E N D I M
Nr.442, datë 16.7.1998

PËR KRIJIMIN E SH.A.- së "AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK"

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Krijimin e "Agjencisë për zhvillimin ekonomik" (AZHE) si shoqëri anonime, me kapital shtetëror, me seli në Tiranë. Veprimtaria e kësaj shoqërie rregullohet sipas statutit që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Objekti i shoqërisë është promovimi i zhvillimit ekonomik të vendit, nëpërmjet:

a) përgatitjes, publikimit dhe shpërndarjes së informacionit ekonomik e promovues;

b) nxitjes së investimeve të huaja e të vendit;

c) nxitjes së tregtisë dhe të eksporteve;

d) promovimit të programit të privatizimit të sektorëve të ekonomisë;

e) propozimit të akteve të nevojshme ligjore e procedurale.

3. Këshilli mbikëqyrës i shoqërisë përbëhet nga gjashtë anëtarë. Në përbërje të këshillit mbikëqyrës të jenë persona që gëzojnë autoritet në fushën e ekonomisë, të financës, të sistemit bankar, të biznesit dhe të informacionit.

Emërimi i organeve drejtuese dhe funksionimi i tyre përcaktohen në statutin e shoqërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për hartimin e akteve të nevojshme për themelimin e shoqërisë dhe regjistrimin e saj në gjykatë.

5. Mjetet kryesore, objektet, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe buxheti i miratuar për vitin 1998, për qendrën shqiptare të nxitjes së investimeve të huaja, i kalojnë sh.a.- së "Agjencia për zhvillimin ekonomik" (AZHE).

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.3, datë 9.1.1993 "Për krijimin e qendrës shqiptare të nxitjes së investimeve të huaja" shfuqizohet.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano